# VENDIM
**Nr. 442, datë 31.7.2025**

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 329, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'NDËRTIMI I LINJËS 110 kV FIBËR – ELBASAN'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 329, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i linjës 110 kV, Fibër–Elbasan", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", "ullishte", "truall", "ndërtesë" dhe "ndërtesë social-ekonomike", me një vlerë të përgjithshme prej 11 936 884 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh.".

b) Në pikën 4, vlera prej "... 558 086 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh" zëvendësohet me vlerën prej "... 11 936 884 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh";

c) Në pikat 10 dhe 11, fjalët "... në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., ..." zëvendësohen me "... në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., ...".

2. Në tabelën që i bashkëlidhet vendimit nr. 329, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Të dhënat e pasurisë, me numër rendor 24, zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Pas numrit rendor 35 shtohen pasuritë me numrat rendorë 36 deri në 45, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operator i Sistemit të Transmetimit sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Belinda Balluku**

# LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV FIBËR–ELBASAN”

| NR. RENDOR | NR. SHTYLLE | PRONARI | | | TË DHËNA KADASTRALE | | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM | | | | | | | | | | SHËNIME | | | Adresa |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | ARË | | | TRUALL | | | NDËRTESË | | | | | | | |
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati ose qyteti | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja Totale | Arë ($m^2$) | Truall ($m^2$) | Ndërtesë ($m^2$) | Sipërfaqja ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | Sipërfaqja ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | Sipërfaqja ($m^2$) | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera (lekë) | Vlera totale (lekë) | Nr. dok | Data e regjistrimit | Seksionet D&E të kartelës së pasurisë | |
| | | *A* | *B* | *C* | *C* | *Ç* | *D* | *E* | *F* | *G* | *H* | *I* | *L* | *M* | *N* | *O* | *P* | *Q* | *R* | *S* | *T* | *U* | | | | |
| **Ndryshime** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **24** | **22** | Alma | Halil | Ibrahimi | Elbasan | 8526 | 2112/3 | ullishte | 822 | | | | 115.0 | 222 | 25,530.0 | | | | | | | 25,530.0 | | | | |
| | | Vasil | | Zaçeliçi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Ismail | | Zaçeliçi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Zana | | Kapja | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Hatixhe | | Alinj | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Meleqe | | Zaçeliçi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Rabihane | Haxhi | Liçi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Ilir | Rexhep | Liçi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Anila | Rexhep | Kovaçi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | Desida | Rexhep | Bica | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **Shtesa** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **36** | **4** | Saimir | Haxhi | Barolli | Shijon | 3371 | 229/18 | arë | 945 | | | | 17.0 | 222.0 | 3,774.0 | | | | | | | 3,774.0 | | | | |
| | | Nafarete | Jashar | Barolli | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **37** | **Midis shtyllave 11_4 dhe 11_5** | Arben | Beshir | Capja | Kusarth | 2346 | 434/3 | ndërtesë social-ekonomike | 2730 | | | | | | | | | | 655.4 | | 9,722,878.03 | 9,722,878.03 | | | | |
| **38** | **Midis shtyllave 11_4 dhe 11_5** | Arben | Beshir | Çapja | Kusarth | 2346 | 434/3/1- ND | ndërtesë | 48.4 | | | | | | | | | | 48.4 | 32695 | 1,582,438 | 1,582,438.0 | | | | |
| | | Anila | Isuf | Çapja | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **39** | **7** | Ramiz | Azem | Plaku | Karakullak | 2346 | 242/6 | arë | 2000 | | | | 70 | 222 | 15,540.00 | | | | | | | 15,540.00 | | | | |
| **40** | **8** | Emin | Ethem | Gjoni | Kusarth | 2346 | 419/33 | arë | 2700 | | | | 62 | 222 | 13,764.00 | | | | | | | 13,764.00 | | | | |
| **41** | **8** | Ilmi | Selim | Ramazan | Kusarth | 2346 | 419/34 | arë | 1200 | | | | 25 | 222 | 5,550.00 | | | | | | | 5,550.00 | | | | |
| **42** | **9** | Petrit | Sali | Halili | Kusarth | 2346 | 419/22 | arë | 1300 | | | | 53 | 222 | 11,766.00 | | | | | | | 11,766.00 | | | | |
| **43** | **9** | Bajram | Hamit | Halili | Kusarth | 2346 | 419/23 | arë | 2600 | | | | 34 | 222 | 7,548.00 | | | | | | | 7,548.00 | | | | |
| **44** | **10** | Refik | Sali | Ahmeti | Kusarth | 2346 | 419/2 | arë | 2500 | | | | 26 | 222 | 5,772.00 | | | | | | | 5,772.00 | | | | |
| **45** | **10** | Jonuz | | Budani | Kusarth | 2346 | 419/1 | arë | 2000 | | | | 44 | 222 | 9,768.00 | | | | | | | 9,768.00 | | | | |
| **SHUMA TOTALE** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | **11,378,798.03** | | | | |